

DITA E MIRË



SHIHET NË MËNGJES

DEMOKRACIA ËSHTË E JONA

GENTA (14), ARGJENDA (13), UJVARA (13), AVDYL (13), LEON (13), REXHEP (14)

NE UDHËHEQIM NË DEMOKRACI

Sa jemi gëzuar që kemi mësuar sot për demokracinë. Këto informata i kemi ndarë më poshtë me ju

Nje ditë isha duke hulumtuar në internet kur më ra në sy një konkurs pune. Në atë konkurs kërkohej një Zyrtar/e Administrativ/e në Ministrinë e Kulturës, Ri-

për herë të parë në kryeqytetin e Greqisë, në Athinë, në vitin 507 p.e.s.

Fatkeqësisht, demokracia e atëhershme ndryshon shumë nga kjo e sotmja. Asokohe, në Athinë kishin të drejtë vote vetëm burrat të cilët kishin shumë toka dhe konsideroheshin të pasur. Me kalimin e kohës kjo gjendje u përmirësua ngadalë dhe tani të gjithë gëzojmë të drejta të barabarta. Disa nga të drejtat tona në demokraci janë: e drejta e shkollimit, e drejta e shprehjes së lirë, e drejta e votës, e drejta e familjes, etj. Ndër të tjerash, demokracia ndahet në dy lloje kryesore. Në demokracinë përfaqësuese dhe atë të drejtpërdrejtë. Në të dy llojet e demokracisë udhëheq populli. Mirëpo, në demokracinë përfaqësuese populli udhëheq përmes përfaqësuesve të cilët i zgjedh. Ndërkaq, në demokracinë e drejtpërdrejtë, populli merr vendime direkt. Kaq nga ne. Ju faleminderit!



Në demokraci mund të jemi vetvetja

nisë dhe Sportit. Aty nuk specifikohet e as nuk kërkohej që të aplikonin vetëm gratë apo vetëm burrat e një feje apo ndonjë race të caktuar, ose ndonjë specifikë tjetër. Përkundrazi, të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës ftoheshin të aplikonin, pa asnjë dallim. Kjo është demokracia ku të gjithë qytetarët janë të barabartë. E, barazia është vetëm njëra nga elementet e demokracisë. Elementet e tjera të demokracisë janë: liria, toleranca, paqja, solidariteti dhe respekti. Sistemi më i mirë i qeverisjes, demokracia, u shfaq



Gazetarët të cilët e shkruajtën këtë artikull

PËRGJEGJËSITË E „SHTËPISË SË POPULLIT“


DIJON (13), GJYLSHAHE (14), ARDIT (14), ALBINA (14), LORENT (14), ELVIRA (13)

Të gjithë ne, kudo që ndodhemi, kemi përgjegjësitë tona të cilat duhet t'i kryejmë

Ne jemi të rinj, të cilët jetojmë në një shtet të ri. Por, pothuajse secili prej nesh ka një familjar që jeton në mërgim. Ligjet e shteteve të ndryshme perëndimore, dallojnë shumë nga ligjet e shtetit tonë. Për shembull, në një shtet perëndimor sipas një ligji në fushën e arsimit, adoleshentëve u mundësohet të shkollohen dhe njëkohësisht të punojnë. Një ligj të tillë, do ta dëshironim edhe ne. Kjo sepse nëse gjatë shkollës së mesme ne do të kishim mundësi punësimi dhe në të njëjtën kohë do të shkolloheshim, atëherë ne do të ishim më të emancipuar dhe më të përgatitur për jetë. Në shtetin tonë kemi gjithsej 120 deputetë të cilët ne me dëshirën tonë i kemi votuar dhe i kemi zgjedhur si përfaqësues të shtetit. Deputetët ndryshe janë të njohur si përfaqësues të popullit.

Këta përfaqësues i miratojnë ligjet të cilat më pas ne do të duhet t'i respektojmë. Përveç miratimit të ligjeve, deputetët si detyrë kryesore e kanë përfaqësimin e qytetarëve, meqenëse prej tyre e fitojnë këtë pozitë. Detyra e tretë kryesore, por jo më pak e rëndësishme është kontrollimi i punës së Qeverisë. Por, ata kryejnë edhe shumë detyra të tjera.


E shihni se sa shumë punë kanë deputetët? Është pothuajse e ngjashme me detyrat që ne i kemi në shtëpitë tona. Për funksionim më të mirë të familjes, ne duhet të mobilizohemi të gjithë dhe të punojmë sa më shumë që mundemi.



Lumturia jonë vjen nga udhëheqësia e mirë e shtetit



Atë që e synojmë, ne e përfundojmë me sukses



Andaj, bëhuni të kujdesshëm në këtë proces, sepse dora juaj është vula e qeverisjes për 4 vjet

MEDIA DHE POPULLI

ELTON (13), ELJON (13), ADRIJAN (13), AGNESA (13), FATLINDI (13), ERLISA (13)



Fuqia na takon ne. Neve që jemi të informuar dhe të ditur



Kur unë flas, unë dëgjohe!

Të dashur lexues të kësaj gazete, ne sot do të flasim për median dhe rolin e saj në demokraci. Ju ftojmë ta lexoni këtë artikull. Faleminderit

Ne sot mësuam se po të mos ekzistonte demokracia, nuk do të ekzistonte as media. Shtrohet pyetja pse? Kjo sepse demokracia na lejon që të marrim dhe të japim informata.

Fjala demokraci përbëhet nga dy fjalë: „demos“ që do të thotë popull dhe „kratos“ që do të thotë qeverisje. Populli, apo të themi më mirë, ne jemi ata të cilët vendosim për personin apo partinë që do ta drejtoj shtetin për 4 vjet. Por, ne së pari duhet t'i përcjellim debatet dhe fushatat e kandidatëve të partive të ndryshme. Më pas, kur të vie dita që duhet të votojmë, ne duhet të përzgjedhim kandidatët për të cilët ne mendojmë se do ta drejtojnë shtetin ose komunën më së miri. Pastaj, duhet të shikojmë se a po i përmbushin premtimet këta kandidatë, tashmë të zgjedhur si përfaqësues tanë. Nëse ai/ajo përfaqësues/e i përmbush ato premtime që i ka dhënë, atëherë ne pas 4 vjetësh do ta votojmë prapë. Por, nëse nuk i përmbushin ato premtime dhe e keqësojnë gjendjen e shtetit apo komunës, ne nuk duhet ta votojmë atë përfaqësues/e përsëri.

Media janë burime, të cilat na tregojnë për ngjarjet më të reja apo informatat më të reja, nga Kosova dhe kudo nga bota. Media na ndihmon për gjëra të ndryshme. Po të mos ekzistonte media, ne nuk do të kishim qasje dhe as kontakt me botën, por as nuk do të kishim asnjë njohuri për botën. Kemi media të shkruara dhe elektronike. Media e shkruar janë: revistat, gazetat, librat, lekturat, etj. Kurse, media elektronike janë: tele-

foni, radio, TV, interneti, portalet, rrjetet sociale, etj. Ne këto lloje të medias i përdorim çdo ditë në jetën e përditshme.

Tani do të flasim për një ide që na erdhi gjatë Punëtorisë së sotme. Kjo ide ka të bëjë me një peticion. Peticioni është një ankesë nga qytetarët e një qyteti ose një shteti për diçka që iu bëhet e padrejtë ose për diçka që kërkojnë ta kenë në komunën e tyre ose në shtet. Peticioni nisët nga një person ose nga një grup personash të cilët duhet të informojnë qytetarët e tjerë përmes një rrjeti social, kanali televiziv apo radios. Për shembull, në komunën e Deçanit çështje me rëndësi është rregullimi i ujit. Grupi ynë mendon që pasi që furnizimi me ujë është i domosdoshëm për qytetarët, duhet të formohet një peticion, të nënshkruhet nga shumë qytetarë dhe të dërgohet në Komunë për t'u rregulluar kjo çështje kaq e rëndësishme. Ne do të informojmë qytetarët e tjerë të Deçanit pikërisht përmes medias. Faleminderit për vëmendjen tuaj!



Edhe ne jemi media. Ne jemi në shërbim të popullit

FËMIJËT JANË E TASHMJA DHE E ARDHMJA

DIJON (13), GJYLSHAHE (14), ARDIT (14), ALBINA (14), LORENT (14), ELVIRA (13)

Në vazhdim, do të mund të lexoni më shumë për të drejtat tona si fëmijë


Çdo shtet, ka rregulla të ndryshme të cilat janë të vendosura nga përfaqësuesit të cilët na përfaqësojnë ne. Në shtetin tonë, këto rregulla miratohen nga deputetët. Një ndër ligjet e miratuara në Kuvend është ligji për të drejtat e fëmijëve.

Ndërsa, Konventa për të Drejtat e Fëmijëve, është miratuar më 20 nëntor të vitit 1989, nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara. Më pas, shumë shtete e pranuan këtë Konventë me qëllim që fëmijët të jenë nën mbrojtjen e saj.


Ndër të drejtat tona si fëmijë janë: e drejta e emrit, e drejta e strehimit, e drejta për të pasur familje, e drejta e shkollimit e shumë të drejta të tjera. Në rast se ndonjëra nga këto të drejta neve na mohohet, ne

kemi të drejtë të ankohemi, sepse shteti ynë na e ka mundësuar që edhe ne të mbrohemi me Konventën për të Drejtat e Fëmijëve.

Lumturia e fëmijëve vie si rrjedhojë e përmbushjes së nevojave tona. Kur ne argëtohem, apo kur shkojmë në shkollë dhe mësojmë për gjëra të ndryshme ne ndihemi të lumtur dhe me fat që jemi pjesë e botës demokratike. Ne jemi nën mbrojtjen e kësaj Konvente deri në moshën 18 vjeçare, sepse pas kësaj moshe, ne konsiderohemi të rritur. Por, edhe të rriturit, i kanë të drejtat e tyre, përderisa jetojnë në një shtet demokratik. Të drejtat e tyre mbrohen, po ashtu, me ligje të ndryshme. E kjo është ajo që themi se demokracia ka shumë ligje dhe të drejta të mira.



Ne jemi fëmijë, por edhe ne i kemi të drejtat tona



Vizioni i një vaje për të ardhmen e shtetit tonë



Zëri ynë dëgjohej kudo në botë



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Dëshmorët e Vokshit“
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: VIII
Website: www.demos-ti.org Vendi: Pobergj, Deçan